



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1300/3 prot.

Tiranë, më 28.12. 2023

V E N D I M

Nr.263, datë 28.12. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 249 regj, datë 20.11.2023, të paraqitur nga znj. M.W kundër Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Shkodër dhe Drejtuesit z.L.K³, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të *moshës, gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, ankuesja M.I.P.W deklaron se, është me origjinë franceze, është diplomuar si albanologe antropologe dhe ka 15 vite që jeton në Shqipëri. Ankuesja pretendon se, policia e migracionit në Shkodër nuk dëshiron që t’i rinovojë lejen e qëndrimit me preteksin se është në moshë dhe është e sëmurë me kancer.

Ankuesja shpjegon se, është e apasionuar pas kulturës tradicionale shqiptare dhe se gëzimi i saj më i madh është t’i tregojë botës bukurinë e madhe të kulturës tradicionale shqiptare dhe që banon në një vend të cilit i kushton respekt të thellë. Ajo punon me komunitetet baritore bjeshkatar në Shqipërinë e Veriut dhe i mbështet ato që të organizohen dhe strukturohen në grupe baritore dhe të bëjnë zërin e tyre të dëgjohet. Aktualisht është këshilltare në Ministrinë e Bujqësisë dhe punon krah për krah me Zyrën Rajonale të Bujqësisë Shkodër. Bashkëpunon

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Në vijim të procedurës është saktësuar mbiemri nga “K” sipas pretendimeve të ankueses në “K”, pas saktësimit të përcjellë nga DVKM Shkodër, nëpërmjet shkresës nr.05/2 prot. datë 15.12.2023.

gjithashtu me Agjensinë e Parkut Kombëtar të Alpeve Shqiptare. Si kryetare e shoqatës “Shtëpia e bariut dhe bjeshkimit” dhe antropologe është anëtare e ANRD.

Ankuesja informon se bashkëpunon me shoqata të shumta që punojnë në favor të blegtorisë ekstensive. Është integruar prej shumë vitesh në Institutin e Studimeve Albanologjike të Universitetit të Shkodrës si studiuese e jashtme dhe punon me disa profesorë të UBT-së. Ajo shprehet se ka sakrifikuar jetën e saj që nga viti 2006 për popullin shqiptar. Kur ishte e sëmurë shumë rëndë në kujdes intensiv në spital në Francë, ka mobilizuar Parlamentin Shqiptar për të njohur praktikën e transhumancës si një trashëgimi ekokulturore jo materiale për t’u mbrojtur nga UNESCO. Ka ofruar aftësitë e saj në përgatitjen e inventarit dhe dosjes për në UNESCO. Ka luajtur një rol të madh në organizimin e Konferencës Shkencore të dhjetorit 2021 “Transhumancë dhe zhvillim rural” nga Universiteti i Shkodrës, si dhe në parlamentin rural të tetorit 2023, ka qenë përgjegjëse përkrah Pr.R.K nga Workshop 4, ruajtja e kulturave tradicionale dhe nxitja e mirëqënies së komuniteteve baritore. Aktualisht është duke përgatitur rekomandimet nga përfaqësues të komunitetit baritor për t’ia sjellë qeverisë shqiptare.

Ankuesja shpjegon se, ka organizuar nisjen e IYRP 2026 nga OKB në Shkodër dhe Bjeshkët e Kelmendit. Aktualisht po bashkon të gjithë aktorët që punojnë në favor të baritorizmit bjeshkatar, për të ndihmuar komunitetet baritore në vështirësi të mëdha dhe të inkurajojnë rishpërndarjen e tyre. Ta ndalosh të vazhdojë të jetojë në Shqipëri, nuk është vetëm t’i shkatërrosh gjithë jetën, por mbi të gjitha t’i provokosh një dënim përfundimtar me vdekje drejtuar blegtorisë së gjerë (ekstensive) malore në të gjithë territorin shqiptar. Ankuesja shprehet se, ndihet thellësisht shqiptare dhe gjithë jetën ia ka kushtuar popullit shqiptar dhe dëshiron që të vazhdojë të japë kontributin e saj.

Ankuesja pretendon se po diskriminohet nga z. L.K, drejtues i Zyrës së Emigracionit në Shkodër, pasi ky i fundit është shprehur se, ajo nuk mund të qëndrojë në Shqipëri pasi është në moshë të thyer dhe e sëmurë me kancer. Ankuesja pranon se ka kaluar kancer, por aktualisht është shumë mirë dhe kjo nuk mund të jetë shkak për të mos rinovuar lejen e saj të qëndrimit në Shqipëri.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke garantuar mbrojtje të drejtpërdrejtë nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, moshës dhe gjendjes shëndetësore, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen*

ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Ankuesja M.W, është shtetase e huaj, me shtetësi franceze, e cila qëndron në territorin e Republikës së Shqipërisë, e pajisur me leje qëndrimi nga autoritetet përkatëse të migracionit. Në referim të nenit 4 “Subjektet”, të LMD ku përcaktohet : “1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë”, ankuesja legjitimohet si subjekt për të paraqitur ankesë pranë Komisionerit.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1300/1 prot, datë 04.12.2023, Komisioneri kërkoi informacion në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë . Në përgjigje të kësaj kërkesë për informacion ka kthyer përgjigje Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Shkodër (DVKM Shkodër), nëpërmjet shkresës nr. 05/2 prot datë 15.12.2023, duke parashtruar si vijon:

Shtetasja M.I.P.W ka një periudhë të gjatë e paisur me leje qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka shërbyer në komunitet e Barinjve në Njësinë Administrative Kelmend, Bashkia Malësi e Madhe.

Me datën 14.11.2023, kjo shtetase ka aplikuar për leje qëndrimi nëpërmjet Portalit E-Albania, duke pasqyruar motivin Studim-Kërkues Shkencor dhe ka ngarkuar në sistem dokumentat të cilat dispononte. Aplikimi i ardhur në sistem është deleguar tek Specialisti i Migracionit Nënkomisar L.K me datën 15.11.2023.

Nga verifikimi i dokumentave nga specialisti z. L.K, ka rezultuar se dokumentat e paraqitura ishin me mangësi dhe konkretisht, me datën 07.12.2023, nëpërmjet sistemit E-Albania shtetases i është dërguar elektronikisht “Njoftimi për plotësimin e dokumentacionit” të kërkuar në bazë të të VKM-së Nr.858, datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i

ndryshuar, Kapitulli III, ku përcaktohet dokumentacioni i përgjithshëm dhe i nevojshëm për të gjitha llojet e lejeve, si dhe shkronja “C”, pika 2, germa “dh”, dokumentacioni shtesë për motivin e kërkuar nga shtetasja duke lënë afat deri me datën 20.12.2023.

Në datën 11.12.2023, kemi marrë kontakt me shtetasen M.W, ku i kemi sqaruar se nga DVKM, nuk është marrë asnjë vendim për refuzimin e aplikimit për leje qëndrimi. Janë plotësuar mangësitë për hedhjen e dokumentave në sistemin E-Albania dhe ka vazhduar procedura normalisht. Shtetases i ka shkuar në e-mail, leja e qëndrimit provizore për një afat 2 muaj, që përkon me periudhën e vlerësimit nga strukturat e tjera zbatuese, deri në miratimin e lejes së qëndrimit sipas kërkesës së aplikantit.

Në lidhje me pretendimin se shtetasja është diskriminuar nga specialisti i migracionit, në kontaktin që kemi patur me shtetasen M.W, ajo shprehet se nuk është takuar vetë personalisht me specialistin e migracionit. Specialisti ka kontaktuar nëpërmjet telefonit me një shtetase të quajtur A.V, e cila është prezantuar si avokate dhe ka kërkuar informacion për aplikimin për leje të shtetases së huaj. Specialisti është përgjigjur se aplikohet në E-Albania dhe dokumentacioni që kërkohet gjendet aty sipas motivit për të cilin kërkohet leja e qëndrimit. Po kështu, pas disa ditësh, është një shtetas tjetër i vetëprezantuar si avokat, i cili i ka kërkuar se si mund të aplikohet për leje qëndrimi por edhe këtij shtetasi i është thënë të aplikojë në E-Albania, sipas motivit që kërkon.

Sipas DVKM Shkodër, nuk ka diskriminim për shkak të moshës apo gjendjes shëndetësore, pasi edhe sipas legjislacionit nuk ka ndonjë kriter ku përcakton moshë për pajisje me leje qëndrimi. Legjislacioni shqiptar parashikon leje qëndrimi për pensionistë.

DVKM Shkodër, sqaron se, baza ligjore për trajtimin e të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë është: Ligji Nr.79, datë 24.06.2021 “Për të huajt”; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.858, datë 29.12.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimi Nr.252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”.

Aplikimi është në procedurë vlerësimi nga organet e tjera ligjzbatuese. Nuk ka asnjë akt refuzimi për këtë shtetase.

1. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 14.12.2023, ankuesja ka informuar se i është miratuar dhe vendosur në dispozicion Leja e Qëndrimit Provizor.
2. Nëpërmjet *e-mailit* datë 17.12.2023, ankuesja ka deklaruar ndër të tjera se, që prej datës 11.12.2023, i është dorëzuar leja e qëndrimit provizor dhe se i kërkon Komisionerit që të

mbyllë çështjen dhe procedurën e shqyrtimit të ankesës së paraqitur prej saj kundër DVKM Shkodër dhe z. L.K. Ndër të tjera, ankuesja kërkon që të konsiderohet i pavlefshme çdo pretendim për diskriminim i ngritur kundër këtyre subjekteve, që ndaj tyre të mos rëndojë asnjë pasojë apo masë, pasi diskriminimi nuk ka ardhur prej tyre, por ka qenë një keqkuptim i tmerrshëm dhe një ndërthurje e disa rrethanave.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëron se, qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur dhe pala ankuese nëpërmjet *e-mailit* të datës 17.12.2023, kërkoi pushimin e çështjes dhe që procesi i shqyrtimit të kësaj ankese të mos vazhdojë, pasi e konsideron çështjen e adresuar pranë Komisionerit nëpërmjet ankesës objekt shqyrtimi, si të zgjidhur.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të LMD, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, përcaktohet: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 249 regjistri, datë 20.11.2023, e paraqitur nga znj. M.W kundër DVKM Shkodër dhe z. L.K, duhet të deklarohet e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative dhe ankuesja e ka tërhequr ankesën.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.249 Regjistri, datë 20.11.2023, të paraqitur nga znj. M.W kundër DVKM Shkodër dhe z. L.K pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Moshë, gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar
Fusha: Të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti